

DEMOCRACY
PLUSDEMOCRACY
DEMOCRACYPLUS
RACYP
CYPL
YSEL
YSELU
YSELU
YSELU
CYPL
PLUS
PLUSDEMOCRACY
DEMOCRACY
PLUSDEMOCRACY



OSHP

Nyja e Prokurimit Publik

Raport i monitorimit të Organit
Shqyrtues të Prokurimit

Mars – qershor 2017

OSHP

NYJA E PROKURIMIT PUBLIK

Raport i monitorimit të Organit
Shqyrtues të Prokurimit



Mars - qershor 2017



E drejta e autorit © 2017. Democracy Plus (D+)
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+.

Raport i përgatitur nga: Isuf Zejna dhe Sara Zhubi

Redaktuar nga: Valmir Ismaili dhe Roberta Osmani

Dizajni grafik nga: Envinion

OSHP Nyja e Prokurimit Publik

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) për herë të dytë është tronditur nga ngritja e aktakuzës për dy anëtarët e Bordit të këtij institucioni. Kjo aktakuzë nuk është e vetmja, pasi që në të kaluarën kreu i OSHP është dënuar për korrupsion. Ndërtimi i një institucioni vlerësues me integritet është qelës i vendosjes së rregullit dhe drejtësisë në prokurimin publik.

Përmbajtja

Përmbledhje.....	9
Hyrje.....	11
Integriteti.....	13
Transparenca.....	14
Transparenca në Seanca.....	14
Mospublikimi i raporteve të ekspertizave.....	16
Mbarëvajtja e seancave të OSHP-së.....	17
Konsistenca e vendimeve.....	17
Mungesa e dëshmitarëve në seanca.....	19
Mos konfiskimi i tarifave të ankesave.....	20
Kompanitë të cilave u janë konfiskuar depozitat.....	21
Kompanitë të cilave nuk i janë konfiskuar depozitat.....	22
Vonesat në vendimmarrje.....	24
Pesë rastet me vonesat më të gjata.....	24
Rastet e zgjidhjes së rasteve para afatit ligjor.....	24
Kompanitë me më së shumti ankesa.....	25
Autoritetet kontraktuese me më së shumti ankesa.....	28
Angazhimi i Ekspertëve.....	33
Ekspertët teknik.....	35
Ekspertët Shqyrtues.....	37
Profilet e ekspertëve.....	38
Rekomandime.....	49

Shkurtesat

AK	Autoriteti kontraktues
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
AK	Autoriteti kontraktues
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
D+	Democracy Plus
DT	Dosje e tenderit
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MI	Ministria e Infrastrukturës
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OE	Operatori ekonomik
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
UP	Universiteti i Prishtinës
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje

D+ ka filluar monitorimin e këtij institucioni në dhjetor të vitin 2016 duke pas parasysh rëndësinë e madhe që ka OSHP në gjithë hallkat e tjera të zingjirit të prokurimit publik, dyshimet për korrupsion dhe mungesën e mbikëqyrjes për këtë institucion të shumë përfulur. Gjatë fazës së parë të monitorimit dhjetor 2016 - shkurt 2017, Democracy Plus (D+) ka identifikuar një numër të problemeve në funksionimin e gjithmbarshëm të prokurimit publik në Kosovë, duke përfshirë edhe praktikën e punës së OSHP-së. Zbatimi i rekomandimeve të këtij raporti drejtuar OSHP-së ka qenë i ngadalshëm dhe me efekte të vogla. Në kuadër të kësaj periudhe të monitorimit ka ndodhur edhe ngritja e aktakuzës, gjë e cila ka zbritur numrin e anëtarëve të OSHP nga pesë në tre anëtarë aktiv të cilët mund të merren me shqyrtimin e ankesave. Në mungesë të Kuvendit dhe si pasojë e bllokadës institucionale ky institucion ballafaqohet me probleme të cilat shkaktojnë vonesa të përgjithshme si pasojë e ngarkesës në punë.

Problemet kryesore të identifikuar në këtë periudhë të raportimit, lidhen me mos konsistencën në vendimet e OSHP-së dhe krijimin e pasigurisë juridike në interpretimin e legjislacionit. Raporti analizon shqyrtimin e disa aktiviteteve të prokurimit për të cilat në faza të ndryshme OSHP ka marr vendime kundërthënëse duke vendosur praktikën e standardeve të dyfishta varësisht se kush janë operatorët. Po ashtu, raporti trajton problemin e shpërfilljes së këtij institucioni nga disa autoritete kontraktuese dhe mungesën e bashkëpunimit me prokurorinë për të adresuar veprat penale të cilat mund të jenë kryer nga kompanitë apo institucionet në fazat e tenderimit. Në mes të OSHP dhe Prokurorisë së Shtetit duket se qëndron një mur i pakalueshëm, pasi që nuk ka asnjë bashkëpunim të dukshëm për adresimin e rasteve të shkeljeve të rënda dhe të qëllimshme në prokurim.

Çështje tjetër e identifikuar është edhe shkelja e afateve kohore nga OSHP për trajtimin e ankesave. Në disa raste shqyrtimi i ankesave mund të jetë shumë efikas dhe i shpejtë, përderisa në rastet tjera vonesat në kundërshtim me Ligjin dhe Rregulloren e OSHP-së mund të arrijnë në dhjetëra ditë, javë ose muaj. Përzgjedhja e lëndëve dhe përfundimi i tyre me kohë bazohen tërësisht në vullnetin e OSHP-së pasi që nuk ka mekanizëm të përzgjedhjes së lëndëve i cili do të parandalonte qasjen subjektive. Angazhimi i ekspertëve dhe matja e performancës së

tyre, vazhdon të jetë problematike, pasi që këta ekspertë përcaktohen sipas preferencave personale të kryeshefit të OSHP-së apo në rastin e ekspertëve të jashtëm nga kryetari i OSHP-së.

Transparenca e cila do të duhej të ishte në nivelin shembullorë për shkak të misionit që ka OSHP, në të vërtetë lë shumë për të dëshiruar. Përveç publikimit të vendimeve të OSHP-së të cilat janë të punuara dhe përcillen me një shkrim të dobët ligjor, dokumentet e tjera si ekspertizat, ankesat dhe dokumentet tjera janë vetëm pjesërisht të publikuara. Çështja e rëndësisë së lartë është edhe votimi i anëtarëve të OSHP-së. Aktualisht as publiku as palët nuk kanë qasje në formën e votimit. Në vendime po ashtu mungon arsyetimi i anëtarëve të cilët kanë votuar kundër vendimit të caktuar, për të arsyetuar votimin e tyre kundërshtues.

Në shumicën e rasteve panelet shqyrtuese nuk e konfiskojnë këtë depozitë të ankesës, pasi që aprovojnë të paktën një nga pretendimet ankimore të operatorëve ekonomik. Për më tepër qëllimi i kësaj depozite nuk është mbulimi i shpenzimeve të OSHP-së, por parandalimi i ankesave të pabazuara të cilat mund ta mbi ngarkojnë punën e paneleve shqyrtuese. Megjithatë, OSHP ka edhe një masë tjetër në dispozicion për të disiplinuar operatorët të cilët paraqesin ankesa të pabazuara. Ligji i Prokurimit Publik i ka dhënë të drejtën që të shqiptojë dënime deri në 5,000 euro për secilën ankesë të pabazuar e cila ka për qëllim vonesën e procedurave. Po ashtu Ligji i ka lejuar edhe dënimet për autoritetet kontraktuese të cilat nuk përfillin vendimet e këtij organi, të cilat mund të përfshijnë ato monetare apo edhe kërkesën për të hequr licencën zyrtarëve të prokurimit.

Në kuadër të kësaj periudhe raportuese OSHP i ka përdorur vetëm në dy raste këto masa duke e dënuar me 10,000 euro komunën e Gjilanit dhe 5,000 euro komunën e Dragashit për mos respektim të vendimeve. Në rastin e komunës së Gjilanit OSHP ka dërguar edhe kërkesën për heqjen e licencës kundër Salih Kçikut zyrtar i prokurimit në Gjilan. Sidoqoftë, rasti i shpërfilljes së vendimeve dhe kërkesave të OSHP-së është shumë më i madh dhe kjo ilustron nga numri i rasteve të cilat shqyrtohen më shumë se një herë në OSHP.

Hyrje

Vlerësimi i tenderëve është proces i cili ka për qëllim të garantoj mjete juridike efektive për ankim nga ana e operatorëve ekonomik në prokurim publik. Si proces i cili përbëhet nga një garë e ngushtë në mes të shumë operatorëve ekonomik, dhe normave juridike komplekse të cilat lejojnë shumëllojshmëri interpretimesh, prokurimi publik në shumë raste mund të përdoret nga institucionet për më shumë sesa për të kryer blerjet e nevojshme. Në Kosovë, frekuenca e shkeljeve në prokurim publik është rritur nga viti në vit, së bashku me buxhetin që kanë institucionet në menaxhim. Për të vendosur drejtësi në prokurim legjislativ i Bashkimit Evropian (BE) kërkon që vendet anëtare të krijojnë një institucion i cili do të bëjë vlerësimin e tenderëve dhe do t'i ofrojë bizneseve të drejtën në mjete juridike të shpejta dhe efikase.

Për këtë qëllim në Kosovë është themeluar Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) i ndarë nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) si entitet i cili bënë nxjerrjen e rregullave dhe monitorimin e prokurimit. Në Kosovë ashtu sikurse edhe në shumicën e vendeve të BE-së ky institucion është i vendosur në kuadër të agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës, rrjedhimisht është institucion administrativ. Disa vende të tjera këtë institucion e kanë në nivel gjyqësor ose kuazi-gjyqësor. E veçanta e këtyre institucioneve për dallim nga gjykatat është se ato mund të përmirësojnë gabimet në proces, para dhënies apo nënshkrimit të kontratave dhe në këtë formë të mbrojnë integritetin e sistemit dhe parandalojnë parregullsitë. Të dy sistemet qoftë ai administrativ apo gjyqësor kanë përparësitë dhe mangësitë e veta. Përderisa institucionet gjyqësore mund të jenë më profesionale, ato zakonisht janë më të ngadalshme në shqyrtimin e ankesave. Në një sistem dinamik të prokurimit publik, vonesat janë të pa pranueshme për shkak të efekteve të shumëfishta që mund të kenë në performancën e institucioneve dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Në mes të kualitetit të shqyrtimit të ankesave dhe efqiencës në kohë, shumë shtete ashtu si edhe Kosova, zgjedhin opsionin e institucionit administrativ. Padia në gjykatë në rastin e Kosovës është gjithashtu një opsion, mirëpo nuk e suspendon aktivitetin e prokurimit. Operatorët ekonomik pra nuk mund ta fitojnë asnjë kontratë përmes gjykatës, ato vetëm mund të kërkojnë kompensimin e dëmeve.

Në Kosovë, me ndryshimet në legjislacion në vazhdimësi ka pasur ndryshime edhe sa i përket funksionimit dhe mandatit të OSHP-së. Në ndryshimet e fundit të Ligjit të Prokurimit Publik në vitin 2016, kanë bërë OSHP-në nivel të dytë të ankesës, pasi që operatorët ekonomik fillimisht duhet të ankohen në kuadër të vetë institucionit që ka menaxhuar me aktivitetin e prokurimit. Ankesat në nivel të autoritetit kontraktues, janë të llojit të kërkesës për të rishqyrtuar lëndën dhe nuk kërkohet depozitë apo pagesë për të iniciuar këtë procedurë. Në anën tjetër ankesat në kuadër të OSHP-së janë të një natyre më të gjerë dhe operatorët ekonomik kanë të drejtë që të kërkojnë nga ky institucion një varg masash, duke kërkuar që të urdhërojë institucionin të ndryshojë kriteret e një aktiviteti të prokurimit, të kthejë lëndët në ri-vlerësim, apo edhe të anulojë një aktivitet në tërësi. Për të parashtruar një kërkesë operatorët ekonomik duhet të paguajnë një depozitë në vlerën e 1% të ofertës së tyre apo 1% të vlerës së parashikuar të kontratës nëse ankesa është bërë para fazës së hapjes së ofertave. Kjo depozitë nuk mund të jetë më e vogël se 100 euro dhe nuk mund të jetë më e madhe se 5,000 euro. Në legjislacionin paraprak e njëjta ka qenë vlerë paushalle prej 500 euro për të gjitha ankesat. Rritja e vlerës së depozitës së ankesave ka ndikuar në uljen e numrit të përgjithshëm të ankesave.

Integriteti

Integriteti i OSHP-së në vazhdimësi është cënuar nga akuzat për korrupsion të cilat kanë përfshirë bordin e këtij institucioni. Përveç, dënimit të ish kreut të tij Hysni Hoxha i cili më pas u shpall i pafajshëm nga Gjykata e Apelit, së fundi dy anëtarë aktual të bordit të OSHP-së janë akuzuar nga prokuroria në lidhje me shqyrtimin e një ankese kundër Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK). Aktakuza lidhet me votimin që këta dy anëtarë kanë bërë në këtë rast në të cilin kanë vendosur të anulojnë një njoftim për dhënie të kontratës. Duke mos paragjykuar fatin e kësaj aktakuze të Prokurorisë së Shtetit dhe fajësinë e dy anëtarëve të OSHP-së dy efekte mund të analizohen nga ky rast:

- Së pari një aktakuzë e tillë e dëmton edhe më shumë besimin në OSHP dhe rritë dyshimet e komunitetit të biznesit dhe vetë publikut në lidhje me paanshmërinë e institucionit dhe për të adresuar këtë, masa serioze duhet të merren në parandalim, si dhe:
- Profesionistët nuk do të jenë të interesuar të jenë anëtarë të OSHP-së në këto rrethana, pasi që rreziku nga aktakuzat do të jetë i madh. Anëtarët nuk kanë asnjë lloj të imunitetit për të votuar sipas bindjeve të tyre duke mos i dhënë llogari askujt për formën e votimit, përderisa të mos ketë prova se ajo është bërë me qëllim të përfitimit.

Mbrojtja nga ndjekja penale e pa përgjegjshme gjithashtu është një dimension që duhet trajtuar, pasi që ngritja e aktakuzës nënkupton pezullimin automatik të anëtarëve të OSHP-së. Në Kosovë në anën tjetër nuk janë të rralla rastet kur aktakuzat dështojnë, madje ato në të shumtën e rasteve nuk arrijnë të vërtetohen në Gjykatë. Në të njëjtën kohë nuk mund të tolerohen personat të cilët kanë aktakuza të ngritura që të punojnë në vlerësimin e ankesave për tender, pasi që kjo do të ishte dëmtim shumë i madh i besimit në punën e institucionit. Duke e pasur parasysh rastin e ish-Drejtorit të Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP) Mursel Rraci, i cili ishte arrestuar dhe akuzuar, për tu liruar pas më pak se 48 orësh dhe nënshkruar një kontratë kontradiktore të cilës i ishte dyfishuar çmimi për punën e njëjtë¹. Ky rasat dhe të tjerët të ngjashëm kanë ngritur dilema nëse ndjekja penale ka pasur për qëllim drejtësinë apo shantazhin ndaj drejtuesit të AQP-së për të nënshkruar një kontratë të dyshimtë.

¹ Saranda Ramaj, Koha.net, Anulimi i tenderit tetëmilionësh për pastrim dërgoi në burg Mursel Rracin. I qasur për herë të fundit më 29.08.2017 në <https://goo.gl/JyJoWh>.

Transparenca

Në raportin paraprak D+ ka identifikuar disa probleme me transparencën e punës së OSHP-së, duke përfshirë problemet me ueb-faqe, njoftimet për seancë publikimin e mangët të ankesave dhe mos publikimin e raporteve të ekspertizës dhe mungesën e raportit vjetor financiar. Një pjesë e rekomandimeve janë pranuar në OSHP, duke filluar me publikimin e një pjese të ekspertizës, përkatësisht pjesën e rekomandimit të ekspertit, OSHP ka publikuar buxhetin, për të cilin ishte kritikuar në raportin e kaluar se nuk e ka përfshirë në kuadër të raportit vjetor. Sidoqoftë, ueb faqja mbetet e pa përshtatshme edhe më tutje, ankesat nuk publikohen të plota dhe një numër i seancave vazhdon të mbahet pa praninë e publikut dhe palëve. Gjithashtu, njoftimet për seanca nuk bëhen në shumë raste në një afat të arsyeshëm kohor, në shumë raste këto njoftime bëhen në afat më të shkurtër se 48 orë e ndonjëherë edhe më të shkurtër se 24 orë.

Transparenca në Seanca

Seancat nuk janë të hapura në të shumë raste, pasi që OSHP tenton që në sa më shumë raste që është e mundur këtë ta bëjë pa praninë e palëve të treta, duke përfshirë edhe palët në kontest dhe monitoruesit. Kjo nuk është e rregulluar me Ligjin e Prokurimit Publik, mirëpo me Rregulloren e OSHP, të cilën e harton vetë institucioni. Në këtë rregullore është paraparë

që disa seanca të mbahen pa praninë e palëve me qëllim të efijencës së institucionit në kohë, për rastet të cilat ballafaqimi i palëve është i pa nevojshëm për shkak se faktet janë mjaftueshëm të qarta sa për të vendosur paneli me ndihmën e ekspertit pa praninë e palëve.

Problemi me seancat e mbyllura qëndron në faktin se nuk u jep të drejtën palëve që të shprehin pretendimet e tyre, sidomos operatorët ekonomik dhe mbi të gjitha mundësinë e kundër-argumentit të institucionit. Ballafaqimi i argumenteve supozohet se e ndihmon panelin në marrjen e vendimit më të drejtë. Në shumë raste nga seancat dëgjimore dhe prezantimet e palëve mund të vërehet se sa i bazuar është pretendimi ankimor dhe në anën tjetër sa me seriozitet ka shqyrtuar një tender autoriteti kontraktues.

Problem tjetër shumë me rëndësi në seancat e mbyllura, është pa mundësia e monitorimit të vendimmarrjes në këto seanca. Për të formuar një vlerësim nëse paneli është i pa anshëm, i drejtë dhe i profesional monitoruesit më së lehti mund të shohin duke u bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të vendimmarrjes. Kjo aktualisht është e pamundur dhe monitoruesit nuk mund të dinë mbi bazën e cilave argumente dhe prova paneli ka vendosur në njërën apo anën tjetër. Për më keq, arsyetimet e vendimeve janë shumë të shkurtra dhe të varfra në argumentim që nuk bindin mjaftueshëm për çfarë arsye është

marr një vendim. Kjo mbase ka ndikuar që në vitin 2015, kundër këtij institucioni në gjykatë të parashtrihen 58 padi². Në vitet paraprake OSHP ka pasur një numër shumë më të vogël të padive, dhe kjo rritje paraqet një paknaqshmëri të palëve me cilësinë e vendimeve.

OSHP si institucion i cili është i thirrur për të mbrojtur ligjshmërinë dhe të drejtat e palëve në prokurimin publik do të duhej të ishte shembull i transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut. Votimi i hapur do të ishte hap i parë dhe shumë i rëndësishëm në vendosjen e praktikave të punës transparente dhe llogaridhënese.

Sidoqoftë, për dallim nga periudha e kaluar raportuese ka një hapje të OSHP-së, pasi që nga 122 seanca të mbajtura 47 kanë qenë të mbyllura,

ndërsa 75 të tjera të hapura. Në përqindje mbi 60 përqind e seancave kanë qenë të hapura për palët dhe publikun. Në periudhën e kaluar nga 105 seanca, 61 kanë qenë të mbyllura dhe vetëm 44 të hapura³. Në përqindje rreth 60 përqind të seancave në këtë fazë ishin të mbyllura. Ky ndryshim paraqet një evoluim pozitiv në transparencën e OSHP, mirëpo që kjo nuk e arsyeton faktin pse 100 përqind të seancave mos të jenë të hapura për palët dhe për publikun. Duke pasur parasysh nivelin e ulët të besimit në OSHP, numrin e aktakuzave, padive dhe ankesave publike të operatorëve dhe autoriteteve kontraktuese, do të duhej që OSHP, të bëjë publike të gjitha seancat, të përshijë në vendime raportet mos pajtuese të anëtarëve të paneleve dhe të pub-

Seancat e OSHP




Tabela 1. Krahasimi i numrit të seancave të OSHP ndërmjet raportit dhjetor 2016 – shkurt 2017 me raportin mars – qershor 2017. Burimi, Raporti i Monitorimit tre mujor të OSHP-së dhjetor 2016 – shkurt 2017.

2 Organi Shqyrtues i Prokurimit, Raporti vjetor i punës për vitin 2016, faqe 25, shkurt 2016. I qasur për herë të fundit më 19.09.2017 në <https://goo.gl/IgXAKp>.


3 Demokraci Plus, (Pa) Drejtësia në Prokurim, Raporti i Monitorimit Tre Mujor të Punës së OSHP-së, Dhjetor 2016-Shkurt 2017, faqe 15. I qasur për herë të fundit më 19.09.2017 në <https://goo.gl/EGdUQv>.

likojë votat e tyre. Në këtë mënyrë do të shprehej vullnet dhe do të dërgohej mesazh për të ofruar llogari publike për të gjitha palët dhe publikun.

Mospublikimi i raporteve të ekspertizave

Në raportin e kaluar D+ ka argumentuar në lidhje me rëndësinë e publikimit të raporteve të ekspertizave, duke përfshirë ekspertët shqyrtues dhe teknik. Kjo me qëllim që të gjitha palët të kenë qasje në rekomandimin e ekspertit, pasi që aty në mënyrë të pavarur dhe profesionale supozohet që të trajtohen pretendimet e palëve. Për këtë arsye është me rëndësi që të gjitha këto ekspertiza të publikohen me qëllim të informimit të publikut dhe palëve të tjera si dhe me qëllim të matjes së kualitetit të punës së ekspertëve.

Kjo përveç transparencës do t'i shërbente edhe vetë efikasitetit në prokurim, pasi që nga ato ekspertiza palët e treta do të mësonin se si duhet interpretuar disa nga normat e Ligjit të Prokurimit Publik. OSHP pas pranimit të raportit të parë të monitorimit ka lëvizur në këtë drejtim, duke i publikuar rekomandimet e ekspertëve për shumicën e lëndëve në shqyrtim. Problemi kryesor në këtë rast qëndron në faktin se ajo çka publikohet është e pamjaftueshme, pasi që përfshinë vetëm një paragraf nga rekomandimi i tij, nëse ankesa duhet të pranohet si e bazuar apo jo, mirëpo mungojnë arsyetimet, rrjedhimisht pjesa kryesore e ekspertizës. Në këtë rast, arsyet janë më të rëndësishme sesa vetë rekomandimi i ekspertit, pasi që në fund të fundit paneli vendos në mënyrë të pavarur në lidhje me vendimin.



Në nivel figurativ zbatimi i këtij rekomandimi të dhënë në raportin paraprak është vlerësuar i përmbushur pjesërisht përkatësisht 25%, pasi që OSHP ka filluar të publikojë rekomandimet por jo edhe raportet e plota të ekspertëve.

Figura 2. Paraqet vlerësimin e D+ në lidhje me nivelin e zbatimit të rekomandimit nga raportit paraprak për monitorimin e OSHP-së.

Mbarëvajtja e seancave të OSHP-së

Në këtë periudhë të monitorimit mars-qershor 2017 janë parashtruar gjithsej 144 ankesa dhe janë nxjerr gjithsejtë 122 vendime. Në përgjithësi, OSHP-në e kanë përcjell të njëjtat sfida për sa i përket mbarëvajtjes së seancave. Menaxhimi i seancave në shumë raste ka qenë i dobët duke i lejuar palët që të bëjnë akuza dhe kundër-akuza në kundërshtim me rregullat bazë të seancës. Po ashtu nuk ka pasur dhe nuk ka udhëzime për sjelljen e palëve në seancat e OSHP-së, për tu ditur se cila është rrjedha dhe formati i seancave. Në të shumtën e rasteve palët prezantohen pa avokat në seancat e OSHP-së dhe kjo është një tregues interesant se pse palët sidomos në tenderët me vlera të lartë vendosin të vetë përfaqësohen duke mos angazhuar avokat apo përfaqësues të specializuar në prokurim dhe legjislacion.

Tarifat e ankesave të cilat janë obligim për të parashtruar ankesa në OSHP në vazhdimësi u kthehen shumicës së kompanive ankuese, duke i inkurajuar që të bëjnë sa më shumë ankesa edhe atëherë kur nuk kanë bazë për këtë, edhe

atëherë kur me vendimet paraprake janë shpallur si të pa përgjegjshme kompanitë. Kjo vije si rezultat i mungesës së konsistencës së vendimeve të OSHP-së dhe shpresës së kompanive se mbase OSHP mund të ndërroj mendjen dhe vendimin e dytë ta marr në kundërshtim me të parin, për çka janë evidentuar shembuj në disa raste. Mos konfiskimi i tarifave, mos ndëshkimi i bizneseve të cilat paraqesin ankesa vetëm sa për të vonuar procedurat, ndryshimi i vendimeve ndikojnë në krijimin e një pasigurie juridike dhe mungesës së vendimmarrjes së standardizuar e ndërlikon gjithë sistemin e prokurimit.

Konsistenca e vendimeve

Gjatë fazës së monitorimit të OSHP-së që nga muaji dhjetor 2016 është vërejtur një fenomen i gjykimit të një rasti më shumë sesa një herë. Për të njëjtin aktivitet të prokurimit janë parashtruar ankesa shumë herë, dhe vendimet e OSHP-së nuk kanë udhëzuar mjaftueshëm autoritetet kontraktues se si ta zbatojnë Ligjin apo vendimin e tyre. Kështu për shembull, një aktivitet i

prokurimit i Ministrisë së Infrastrukturës për Asfaltimin e rrugës Babush, Tërn, Luboc, Koshare dhe Slivovë, është gjykuar tri herë deri më tani në OSHP.

Nga shqyrtimi i këtij rasti, mund të nxirren përfundime të rëndësishme që tregojnë probleme themelore me punën e OSHP-së dhe raportin me autoritetet kontraktuese:

- Përfshihet nga gara operatori më i lirë në aktivitet Renelual Tahiri, për mungesë të deklaratave nën betim se inxhinierët e saj nuk janë të angazhuar në projekte të tjera në Ministrinë e Infrastrukturës. Kjo është e pa arsyeshme pasi që një gjë të tillë mund ta vërtetojë vetë Ministria nga të dhënat e brendshme. Në anën tjetër Ligji lejon që t'i kërkojnë sqarime shtesë operatorit në raste të tilla, me qëllim të shpërblimit me kontratë operatorët më të lirë.
- Renelual Tahiri edhe pse është shpallur i pa përgjegjshëm nga vendimi i parë i OSHP-së i është aprovuar ankesa pjesërisht në raundin e dytë ndërsa në anën tjetër është thënë se operatori është i papërgjegjshëm. Në të njëjtën mënyrë edhe në raundin e tretë kur ky aktivitet është shqyrtuar edhe pse me dy vendimet paraprake ishte shpallur i papërgjegjshëm është ftuar në seancë për të prezantuar pretendimet e saja ankimore. Në anën tjetër në asnjë rast nuk i është konfiskuar tarifa apo depozita e ankesës. Nëse një operator e din qartë se është i papërgjegjshëm dhe parashtron ankesë, atij jo vetëm se duhet t'i konfiskohet depozita e ankesës që në këtë

rast është shuma maksimale 5,000 euro, por edhe duhet të dënohet me 5,000 euro të tjera.

- Kompania 2A Group është favorizuar nga paneli shqyrtues tek pjesa e garancionit bankar. Kjo për arsye se kompania që ishte rekomanduar për herë të dytë për të shpërblyer me kontratë Gërlica, nga OSHP ishte gjetur e pa përgjegjshme pasi që garancioni i saj bankar nuk thoshte se banka do ta përkrah me 200,000 euro në rast të fitimit të kontratës. Në të njëjtën kohë edhe garancioni bankar i kompanisë 2A Group nuk e thoshte shprehimisht se banka do ta përkrah me 200,000 euro. OSHP gjeti se 2A Group e plotëson këtë kërkesë të dosjes së tenderit edhe pse ajo kishte probleme të ngjashme me garancionin e kompanisë Gërlica.
- Operator tjetër që ka parashtruar ankesë është në fazën e dytë të shqyrtimit të aktivitetit të prokurimit është Kompania Bageri. Kjo kompani kishte akuzuar publikisht se inxhinieri i saj ishte përdorur nga një kompani tjetër përkatësit konsorciumi Papenburg & Ardiani në dy tenderë paraprak, duke i falsifikuar dokumentet⁴. Për këtë çështje OSHP nuk ka ndërmarrë asnjë veprim dhe nuk ka njoftuar prokurorinë. Në lidhje me falsifikim të dokumenteve OSHP duhet të marrë masën e futjes në listë të zezë kompanitë.
- Ministria e Infrastrukturës me vendimin nr. 98/17, 105/17, me datën 31.05.2017 i kishte marrë afat prej 10 ditësh që të kryej procedurat e rivlerësimit dhe të bëjë rivlerësim në lidhje me vendimin e OSHP-së. Pas përafër-

⁴ Organi Shqyrtues i Prokurimit, Bageri v. Ministria e Infrastrukturës, Nr. 398, 401, 403/16. I qasur për herë të fundit më 03.09.2017 në <https://goo.gl/hsSK7s>.

sisht tre muajsh Ministria e Infrastrukturës ende nuk ka marr një vendim në lidhje me këtë procedurë dhe në anën tjetër nuk ka ndonjë reagim të OSHP-së. Kjo paraqet një shpërfillje të hapur nga Ministria në raport me OSHP-në.

Rast tjetër në të cilin ka pasur mos konsistencë të OSHP-së është edhe aktiviteti i prokurimit Rregullimi i shtratit të lumit të Bifurkacionit dhe trotuaret pranë lumit Nerodime. Ky rast është shqyrtuar tri herë në OSHP dhe është në radhë për tu shqyrtuar për herë të katërt. Në të gjitha rastet Komuna e Ferizajt si Autoritet Kontraktues i ka zbatuar rekomandimet e OSHP-së dhe prapë se prapë janë aprovuar ankesat e operatorëve ekonomik ankues tri herë radhazi. Në këtë rast është përkrahur hapur dhe kundërligjshëm operatori Linda i cili sipas Ligjit të Prokurimit Publik ka qenë i pa përgjegjshëm pasi që pronari i saj gjendet në vuajtje të dënimit të formës së prerë të gjykatës. Vendimet e OSHP kanë rënë ndesh me njëra tjetrën dhe OSHP ka mbyllur sytë pranë faktit se Kompania Linda nuk ka të drejtë të shpërblehet dhe as të zbatojë këtë kontratë. Në lidhje me këtë tender Democracy Plus dhe Insajderi kanë publikuar një seri të shkrimeve në të cilën është trajtuar në detaje ky aktivitet i prokurimit⁵.

Rast tjetër në shqyrtim më shumë se një herë është edhe aktiviteti i prokurimit në Komunën e Dragashit për projektin e ndërtimit të ujësjellësit në Komunën e Dragashit. Në këtë aktivitet të prokurimit për të cilin OSHP ka nxjerr katër vendime, Komuna e Dragashit në vazhdimësi i ka

shpërfillur vendimet e OSHP-së dhe ka diskriminuar operatorin Puna, i cili sipas vendimit të OSHP-së ka qenë i përgjegjshëm, përderisa komuna tri herë radhazi nuk e ka shpërblyer me kontratë.

Në fund me Vendimin 50/17, OSHP e ka dënuar Komunën me 5,000 euro. Sidoqoftë, shpërfillja e vazhdueshme e vendimeve të një institucioni si OSHP, nuk duhet të tolerohet për kohë kaq të gjatë dhe operatorit duhet t'i ndahet kompensim i dëmit në përputhje me kompetencat e OSHP. Në këtë procedurë nuk është iniciuar as edhe heqja e licencës për zyrtarin e prokurimit. Të gjitha këto të dhëna tregojnë për pafuqinë sistematike të OSHP-së për të detyruar institucionet që të veprojnë në përputhje me vendimet e saj. Në këtë rast komuna ka përdorur arsyetime jo të ligjshme për të diskualifikuar një operator dhe me çdo çmim ka tentuar mos ta shpërblejë me kontratë përkundër çmimit më të ulët dhe plotësimit të kriterëve të dosjes së tenderit.

Mungesa e dëshmitarëve në seanca

Nuk janë të rralla rastet kur në seanca të OSHP-së pikë kryesore e kontestit në mes të institucioneve dhe operatorëve, apo operatorëve në mes vete është një referencë e dyshimtë, një deklaratë se ky apo ai artikull është i papërshtatshëm sipas njësive të kërkesës. Në këto raste do të ishte e preferueshme që të ftohen për të dëshmuar përfaqësuesit e institucioneve, personat privat apo palë të tjera të cilët do ta ndih-

5 Insajderi dhe Demokrasi Plus, EL-Chapo Kosovar që arriti të përfitojë mbi 1 milion euro nga tenderët publik. I qasur për herë të fundit më 21.08.2017 në <https://goo.gl/D25DgU>.

monin panelin përkatës shqyrtues në marrjen e vendimit.

Pas publikimit të raportit paraprak ku ishte identifikuar problemi me mos thirrjen e dëshmitarëve në asnjë seancë të OSHP-së, këtë herë ekspertët dhe palët kanë kërkuar të ftohen institucione apo persona të tjerë për të dëshmuar. Në një rast kompania Ndërtimi për shkak të disa problemeve që ka pasur me platformën e prokurimit ka kërkuar që dikush nga KRPP të jetë dëshmitar në këtë rast.

Pasi që problemi për të cilin ishte eliminuar kishte të bënte me sistemin dhe llogaritjen e çmimeve dhe jo me ofertën e saj si operator. OSHP nuk ka marr parasysh kërkesën dhe nuk ka ftuar KRPP-në të dëshmojë në lidhje me këtë problem, nëse me të vërtetë problemi ishte i platformës së prokurimit apo ky pretendim ishte i pavërtetë. Në këtë rast kësaj kompanie i është mohuar e drejta nga OSHP si pasojë e mos thirrjes së KRPP për të dëshmuar në lidhje me rastin. Për më tepër përfaqësuesi i autoritetit kontraktues nuk ishte paraqitur fare në seancë, duke e shpërfillur ftesën e OSHP-së për pjesëmarrje⁶.

Po ashtu edhe një ekspert shqyrtues i brendshëm i OSHP në seancën NNP Apling v. Komuna e Lipjanit, Nr. 190/17, ka rekomanduar si opsion, që të ftohet si dëshmitar një inxhinier i elektros i cili ishte kërkuar me dosje të tenderit dhe çështja e të cilit ishte shndërruar në kontest në mes të palëve. Paneli i OSHP-së nuk e ka diskutuar këtë çështje dhe nuk e ka trajtuar

kërkesën e ekspertit për ta pasur si dëshmitar këtë person⁷.

Mos konfiskimi i tarifave të ankesave

Brenda kësaj periudhe raportuese edhe pse janë parashtruar 144 ankesa, që paraqet një numër të mjaft të madh të pakënaqësive të operatorëve ekonomik me autoritetet kontraktuese, në shumicën absolute të rasteve OSHP nuk ka konfiskuar depozitat të cilat operatorët janë të obliguar të paguajnë për ankesa në formë të tarifës. Kjo tarifë është vendosur me qëllim të parandalimit të ankesave të pabazuara dhe qëllimi i vetëm i të cilave është që të vonojnë procedurat e prokurimit. OSHP në 48 raste ka vendosur në favor të autoriteteve kontaktuese dhe 71 raste në favor të operatorëve ekonomik. Nga ky numër prej 48 rasteve në të cilat është vendosur në favor të autoriteteve kontraktuese, ku ankesat nuk u janë aprovuar operatorëve ekonomik, vetëm në 13 raste janë konfiskuar depozitat e ankesës, përderisa 36 raste të tjera operatorët ekonomik janë “falur” nga OSHP dhe nuk u është konfiskuar kjo tarifë edhe pse nuk kanë arritur t’i vërtetojnë deri në fund pretendimet ankimore.

6 Organi Shqyrtues i Prokurimit, Ndërtimi v. Komuna e Klinës, Nr. 232/17. I qasur për herë të fundit më 29.08.2017 në <https://goo.gl/ykXd3M>.

7 Organi Shqyrtues i Prokurimit, NNP Apling v. Komuna e Lipjanit, Nr. 190/17. I qasur për herë të fundit më 29.08.2017 në <https://goo.gl/zoNRoX>.

Konfiskimi i tarifave për ankesa




Tabela 3. Paraqet krahasimin e numrit të ankesave, vendimeve të panelit dhe numrit të vogël të tarifave të konfiskuara.

Kompanitë të cilave u janë konfiskuar depozitat

Nr.	Emri i Kompanisë	Institucioni kundër të cilit janë ankuar	Paneli
1	Telekomi i Kosovës	Komuna e Gjakovës	Goran Milenkovic
2	Aritech	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	Ekrem Salihu
3	Luani	Komuna e Prishtinës	Tefik Sylejmani, Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic
4	ATM-PR	KEK	Tefik Sylejmani, Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic
5	NTP Ballkan Petrol	Trepça	Ekrem Salihu, Tefik Sylejmani, Nuhi Paçarizi
6	SNR	KEK	Tefik Sylejmani, Ekrem Salihu, Nuhi Paçarizi
7	Union	QKUK	Tefik Sylejmani, Goran Milenkovic, Blerim Dina
8	Botek	MI	Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic, Blerim Dina
9	Buli Medical	Spitali i Përgjithshëm Gjilan	Goran Milenkovic, Tefik Sylejmani, Nuhi Paçarizi
10	Office Printy	Këshilli Prokurorial i Kosovës	Goran Milenkovic
11	Marisa & Benita	Komuna e Gjakovës	Nuhi Paçarizi, Tefik Sylejmani, Blerim Dina
12	Shqiponja	Kuvendi i Kosovës	Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic, Blerim Dina
13	ICN BM	MSH	Ekrem Salihu, Tefik Sylejmani, Nuhi Paçarizi

Tabela 4. Paraqet të dhënat e kompanive të cilave u janë konfiskuar tarifatat e ankesave.

Kompanitë të cilave nuk u janë konfiskuar depozitat

Nr	Emri i Kompanisë	Institucioni kundër të cilit janë ankuar	Paneli
1	TTC	KEK	Blerim Dina, Tefik Sylejmani, Goran Milenkovic, Ekrem Salihu, Nuhi Paçarizi
2	El-Bau & Ve-Mor	Komuna e Kacanikut	Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic, Blerim Dina
3	Besi	MKK	Nuhi Paçarizi
4	DËH Kosova	KEK	Blerim Dina
5	Euro Ing	KEK	Tefik Sylejmani, Ekrem Salihu, Nuhi Paçarizi
6	Pharmachem-De-ga KS	UP "Hasan Prishtina"	Ekrem Salihu, Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic
7	FAM & NTSH ECO-INVEST	KEK	Goran Milenkovic, Ekrem Salihu, Blerim Dina, Nuhi Paçarizi, Tefik Sylejmani
8	Artius Group	Zyra e Presidentit të Kosovës	Goran Milenkovic, Blerim Dina, Nuhi Paçarizi
9	Pastor Kosova & Professional Alarm	KEK	Blerim Dina, Ekrem Salihu, Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic, Tefik Sylejmani
10	Fans a.s & NPSH Electronic Business PRO	KEK	Nuhi Paçarizi, Tefik Sylejmani, Ekrem Salihu, Blerim Dina, Goran Milenkovic
11	Albkos INT NTSH	Komuna e Gjilanit	Ekrem Salihu
12	Arlindi & Berisha Company SHA	KRU Hidromorava	Goran Milenkovic, Tefik Sylejmani, Blerim Dina
13	Geo & Land	MFSK	Tefik Sylejmani, Ekrem Salihu, Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic, Blerim Dina
14	Info Com	MASHT	Nuhi Paçarizi, Tefik Sylejmani, Goran Milenkovic
15	NTG Blendi	QKUK	Blerim Dina, Goran Milenkovic, Nuhi Paçarizi
16	NTP Flamuri	Komuna e Suharekës	Goran Milenkovic, Tefik Sylejmani, Nuhi Paçarizi
17	Infinet	Komuna e Kaçanikut	Nuhi Paçarizi, Tefik Sylejmani, Ekrem Salihu
18	Plan 2	Komuna e Prizrenit	Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic, Blerim Dina
19	Europrinty	UP "Hasan Prishtina"	Tefik Sylejmani, Goran Milenkovic, Blerim Dina
20	Eco-Higjiena	Komuna e Vitisë	Goran Milenkovic, Tefik Sylejmani, Nuhi Paçarizi
21	Botek	Policia e Kosovës	Tefik Sylejmani, Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic
22	Sfinga	Komuna e Prizrenit	Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic, Blerim Dina
23	Pe-Vla-Ku	Komuna e Gjakoves	Nuhi Paçarizi, Blerim Dina, Tefik Sylejmani
24	Audit Group	KEK	Nuhi Paçarizi, Blerim Dina, Tefik Sylejmani

25	Shkelqimi Project & A1 Engineering	Komuna e Vitisë	Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic
26	1. Sodex Group , 2. Poligoni I shen-jtërisë Katana	Policia e Kosovës	Blerim Dina, Ekrem Salihu, Tefik Sylejmani, Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic
27	New-Line	Komuna e Prishtines	Blerim Dina, Tefik Sylejmani, Nuhi Paçarizi
28	Xani Inex	KEK	Blerim Dina, Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic
29	PBC	KRU Hidromorava	Nuhi Paçarizi, Tefik Sylejmani, Blerim Dina
30	Uni Project	MAP	Goran Milenkovic, Nuhi Paçarizi, Blerim Dina
31	SFK Security	Komuna e Prizrenit	Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic, Blerim Dina
32	Segment Kosova	Trepça	Blerim Dina, Nuhi Paçarizi, Goran Milenkovic

Tabela 5. Paraqet të dhënat e kompanive të cilave nuk u janë konfiskuar tarifat e ankesave.

Vonesat në vendimmarrje

Në kuadër të kompetencave të saj, OSHP po ashtu ka një numër të kufizimeve kohore brenda të cilës ka për obligim të vendos për ankesat. OSHP ka kohë 30 ditë kalendarike për të mbajtur seancën e vendimmarrjes dhe katër ditë për të hartuar vendimin. Sidoqoftë, ky afat kohor rrallë

herë respektohet. Nga matja e kohëzgjatjes së shqyrtimit të ankesave nga D+ duke u bazuar në të dhënat e publikuara në ueb faqen e institucionit, del se vendimet janë nxjerr brenda afateve prej 19 ditësh kalendarike⁸ deri në 73 e cila përbënë vonesë ligjore prej 39⁹ ditësh.

Pesë rastet me vonesa më të gjata në nxjerrjen e vendimeve

Operatori	Institucioni kundër të cilit ankohet	Ditë deri në publikim	Ditët e vonesës
Limit L&B	Komuna e Prizrenit	73	39
Dromodoli Commerce	Komuna e Novobërdës	67	33
ATM-PR	KEK	65	31
Ballkan Petrol	Trepça	65	31
1. Sodex Group, 2. Katana	Policia e Kosovës	63	29

Tabela 6. Paraqet të dhënat e rasteve në të cilat ka pasur më së shumti vonesa nga data e dorëzimit deri në publikimin e vendimit nga OSHP. Me Ligjin e Prokurimit OSHP obligohet të nxjerr vendimin brenda 34 ditëve.

Rastet e zgjidhjes së rasteve para skadimit të afatit ligjor

Operatori	Institucioni kundër të cilit ankohet	Ditë deri në publikim	Ditët e vonesës
Office Printy	KPK	19	N/A
Yess Pharma	MPB	20	N/A
Uni Care	Spitali Regjional i Prizrenit	28	N/A
Aritech	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	28	N/A
Xani Inex	KEK	28	N/A

Tabela 7. Paraqet të dhënat e rasteve në të cilat nuk ka pasur vonesa në nxjerrjen e vendimeve, përkundrazi vendimet janë nxjerr para skadimit të afatit ligjor.

8 Organi Shqyrtues i Prokurimit, Vendimi Office Printy v. Këshilli Prokurorial, nr. 154/17.

9 Organi Shqyrtues i Prokurimit, Vendimi Limit L&B v. Komuna e Prizrenit, nr. 51/17.

Kompanitë me më së shumti ankesa

Kompanitë me më së shumti ankesa në OSHP janë: Er-Lis & Ve-Mor , Security Code, Botek, PBC, Infnit dhe Uni Project, pretendimet ankimore të të cilave në të shumtën e rasteve janë vlerësuar si të bazuara nga ekspertët dhe është vendosur në favor të tyre nga paneli shqyrtues.

1. **Er-Lis & Ve-Mor** - Nga të dhënat e nxjerra në këtë fazë të monitorimit, konzorciumi në fjalë ka paraqitur pesë herë ankesë në OSHP.

